



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 764/12 Prot.,

Datë 03.04.2026

V E N D I M

Nr. 470/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtare
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.04.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.435/2026, datë 27.03.2026, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-73633-01-06-2026, me objekt Mirëmbajtja e Sistemit të HVAC (ngrohja, ventilimi dhe kondicionimi i ajrit) përgjatë ambjenteve të Gazsjellësit TAP” me fond limit 16,483,084 (gjashhtëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë e katër) lekë pa tvsh dhe/ose 170,720.70 (njëqind e shtatëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet pikë shtatëdhjetë) euro pa tvsh. Kursi zyrtar i këmbimit i Bankës së Shqipërisë, datë 06.01.2026 është 96.55 lekë/Euro, zhvilluar në datën 16.02.2026 nga autoriteti kontraktor, “Albanian Gas Services Company” Sh.A.

Ankimues:

OE “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK me NIPT K21710002J dhe me adresë, Rruga "Murat Toptani", Godina Eurocol, Kati 8, Tiranë, Shqipëri.

Autoriteti Kontraktor:

“Albanian Gas Services Company” Sh.A me adresë Rruga e Kosovareve, Pallati Ndërpro shpk, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i

ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 27.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.435/2026, ku vendosi:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-73633-01-06-2026, me objekt Mirëmbajtja e Sistemit të HVAC (ngrohja, ventilimi dhe kondicionimi i ajrit) përgjatë ambjentëve të Gazsjellësit TAP” me fond limit 16,483,084 (gjashtëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë e katër) lekë pa tvsh dhe/ose 170,720.70 (njëqind e shtatëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet pikë shtatëdhjetë) euro pa tvsh. Kursi zyrtar i këmbimit i Bankës së Shqipërisë, datë 06.01.2026 është 96.55 lekë/Euro, zhvilluar në datën 16.02.2026 nga autoriteti kontraktor, “Albanian Gas Services Company” Sh.A.
2. Autoriteti kontraktor të kualifikojë operatorin ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën përcjellëse me nr. 9/10 prot., datë 31.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 764/9 prot., datë 02.04.2026, autortiteti kontraktor “Albanian Gas Services Company” Sh.A, ka dërguar me shërbim postar, informacion mbi zbatimin e vendimit të KPP-së Nr. 435/2026, datë 27.03.2026.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën përcjellëse me nr. 9/10 prot., datë 31.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 764/9 prot., datë 02.04.2026, autortiteti kontraktor “Albanian Gas Services Company” Sh.A, ka dërguar me shërbim postar, informacion mbi zbatimin e vendimit të KPP-së Nr. 435/2026, datë 27.03.2026.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik si edhe informacioni i dërguar me shkresën përcjellëse me nr. 9/10 prot., datë 31.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 764/9 prot., datë 02.04.2026, nëpërmjet shërbimit postar, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor “Albanian Gas Services Company” Sh.A, ka kryer ri-vlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.435/2026, datë 27.03.2026, duke rivlerësuar këtë subjekt ofertues “*Advanced Business Solutions – ABS*” SHPK dhe pas rivlerësimit statusi nga “I skualifikuar” është ndryshuar në statusin “I kualifikuar”, ku këto veprime janë pasqyruar nga autoriteti kontraktor me informacionin e dërguar.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara*”, me Nr. REF-73633-01-06-2026, me objekt Mirëmbajtja e Sistemit të HVAC (ngrohja, ventilimi dhe kondicionimi i ajrit) përgjatë ambjenteve të Gazsjellësit TAP” me fond limit 16,483,084 (gjashtëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë e katër) lekë pa tvsh dhe/ose 170,720.70 (njëqind e shtatëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet pikë shtatëdhjetë) euro pa tvsh. Kursi zyrtar i këmbimit i Bankës së Shqipërisë, datë 06.01.2026 është 96.55 lekë/Euro, zhvilluar në datën 16.02.2026 nga autoriteti kontraktor, “Albanian Gas Services Company” Sh.A.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

